

**Mati Hydropower sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

## Përmbajtje

Raporti i audituesit të pavarur .....	i
Bilanci kontabël .....	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve .....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital .....	3
Pasqyra e flukseve monetare .....	4
1. Informacion i përgjithshëm .....	5
2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare .....	5
3. Politikat kontabël .....	6
4. Mjetet monetare dhe ekuivalente .....	11
5. Aktive të tjera afatshkurtra .....	11
6. Aktive afatgjata materiale .....	11
7. Llogari të arkëtueshme nga koncesioni .....	11
8. Aktive afatgjata jo materiale .....	12
9. Llogari të pagueshme .....	12
10. Detyrime të tjera .....	12
11. Huatë .....	12
12. Kapitali i paguar .....	13
13. Shpenzime për personelin .....	13
14. Shpenzime operative .....	14
15. Të ardhura nga kursi i këmbimit .....	14
16. Tatimi mbi fitimin .....	14
17. Palë të lidhura .....	14
18. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara .....	15
19. Menaxhimi i riskut financiar .....	16
20. Ngjarje të mëpasshme .....	17

## *Raporti i Audituesit të Pavarur*

Drejtuar Aksionarëve të Mati Hydropower sh.p.k

### *Opinionin ynë*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Mati Hydropower sh.p.k (“Shoqëria”) më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (“SKK”).

#### **Ne kemi audituar:**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

### *Baza për opinionin*

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

#### **Pavarësia**

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (“kodi i BSNEK”), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### *Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare*

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k*

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k  
Tiranë, Shqipëri  
24 prill 2017

  
Auditues ligjor  
Laureta Peci Kellici

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Mjete monetare			
Aktive të tjera afatshkurtra	4	441,299	304,752
Tatim i arkëtueshëm mbi fitimin	5	145,423,019	129,147,799
		40,000	40,000
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>145,904,318</b>	<b>129,492,551</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	1,552,341	1,944,445
Të arkëtueshme nga konçesioni	7	299,868,586	266,017,050
Aktive afatgjata jo materiale	8	399,824,781	354,689,400
Aktive të tjera afatgjata		-	2,278,974
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>701,245,708</b>	<b>624,929,869</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>847,150,026</b>	<b>754,422,420</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	9	101,122,346	57,605,669
Detyrime të tjera afatshkurtra	10	1,104,738	7,357,085
Huamarrje	11	65,300,221	39,752,827
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>167,527,305</b>	<b>104,715,581</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Huamarrje	11	691,363,375	630,732,960
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>691,363,375</b>	<b>630,732,960</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>858,890,680</b>	<b>735,448,541</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i paguar	12	93,100,000	93,100,000
Humbjet e akumuluar		(104,840,654)	(74,126,121)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>(11,740,654)</b>	<b>18,973,879</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>847,150,026</b>	<b>754,422,420</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Mati Hydropower sh.p.k. më 27 Mars 2017, dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Aida Nani  
Administratore

Rézarta Kocollari  
Kontabiliste



## Mati Hydropower sh.p.k.

### Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura		-	-
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzime të personelit			
<i>Shpenzime paga</i>	13	(10,556,524)	(10,166,459)
<i>Sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i>	13	(894,761)	(851,387)
Shpenzime operative	14	(11,621,265)	(12,195,521)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(392,104)	(491,473)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(23,464,654)</b>	<b>(23,704,840)</b>
<b>Humbja nga veprimtaria kryesore</b>		<b>(23,464,654)</b>	<b>(23,704,840)</b>
<b>Të ardhura dhe shpenzime financiare</b>			
Shpenzime interesi		(19,908,720)	(31,633,961)
Të ardhura nga kurset e këmbimit	15	12,658,841	14,387,499
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>(7,249,879)</b>	<b>(17,246,462)</b>
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(30,714,533)</b>	<b>(40,951,302)</b>
Tatimi mbi fitimin	16	-	-
<b>Humbja e vitit</b>		<b>(30,714,533)</b>	<b>(40,951,302)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Humbje gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(30,714,533)</b>	<b>(40,951,302)</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **Mati Hydropower sh.p.k.** **Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

*(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

	<b>Kapitali i paguar</b>	<b>Humbja e akumuluar</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendje më 1 janar 2015</b>	<b>93,100,000</b>	<b>(33,174,819)</b>	<b>59,925,181</b>
Kapitali i paguar (shënimi 12)	-	-	-
Humbja e vitit	-	(40,951,302)	(40,951,302)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2015</b>	<b>93,100,000</b>	<b>(74,126,121)</b>	<b>18,973,879</b>
Humbja e vitit	-	(30,714,533)	(30,714,533)
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2016</b>	<b>93,100,000</b>	<b>(104,840,654)</b>	<b>(11,740,654)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Pasqyra e flukseve të parasë

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
<b>Humbja para tatimit</b>			
Rregullime për:		<b>(30,714,533)</b>	<b>(40,951,302)</b>
Shpenzime të amortizimit	6	392,104	491,473
Shpenzime interesi		-	31,633,961
<b>Fitimi operativ përpara ndryshimit në kapitalin qarkullues</b>		<b>(30,322,429)</b>	<b>(8,825,868)</b>
Rritje në aktive të tjera afatshkurtra	5	(16,275,220)	(23,178,671)
Rënie/(Rritje) në aktive të tjera afatgjata		2,278,974	(24,233)
Rritje/(Rënie) në llogari të pagueshme	9	43,516,677	(350,222,096)
Rritje/(Rënie) në detyrime të tjera afatshkurtra	10	(6,252,347)	7,112,800
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(7,054,345)</b>	<b>(375,138,068)</b>
Interesi i paguar		-	-
Tatim fitimi i paguar		-	-
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(7,054,345)</b>	<b>(375,138,068)</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e investimit</b>			
Llogari të arkëtueshme nga konçesioni	7	(33,851,536)	(35,677,940)
Të drejta nga konçesioni	8	(45,135,381)	(47,570,587)
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë e investimit</b>		<b>(78,986,917)</b>	<b>(83,248,527)</b>
<b>Flukset monetare nga veprimtaritë e financimit</b>			
Hua të marra	11	86,177,809	456,790,216
<b>Flukset monetare neto nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>86,177,809</b>	<b>456,790,216</b>
<b>Rritje/(Rënie) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente</b>		<b>136,547</b>	<b>(1,596,440)</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalente në fillim të periudhës	4	304,752	1,901,191
Mjetet monetare dhe ekuivalente në fund të periudhës	4	441,299	304,752

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 17, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# **Mati Hydropower sh.p.k.**

## **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

### **1. Informacion i përgjithshëm**

Mati Hydropower sh.p.k. është një filial i zotëruar në masën 90% nga shoqëria Enso Hydro Energji sh.p.k. (me seli në Tiranë, Shqipëri), e cila është 80% filial i enso hydro GmbH, shoqëria mëmë me seli në Austri. Shoqëria është themeluar më 11 tetor 2012 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si entitet ligjor më 12 tetor 2012 me numrin unik të identifikimit L22212004A.

Veprimtaria kryesore e Shoqërisë është ndërtimi, operimi sipas Kontratës së Konçesionit si dhe transferimi i hidrocentraleve të vegjël sipas konçesionit "Stavec" tek Autoriteti Kontraktues duke përfshirë financimin, ndërtimin, vendosjen në punë, dhe prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen lokale të energjisë.

Administratorët e Përgjithshëm të Shoqërisë janë Znj. Aida Nani dhe Z. Georg Schweighofer.

Selia qendrore e shoqërisë është në Rr. "Jul Variboba", Vila Nr 10, Tiranë, Shqipëri.

Numri i personelit më 31 dhjetor 2016 është 6 (31 dhjetor 2015: 5).

### **Kontrata konçesionare**

Qeveria e Shqipërisë ka hyrë në një kontratë konçesionare me një grup shoqëri (përkatësisht Riviera sh.p.k., EHW sh.p.k., Energji Project sh.p.k. and Atlantik sh.a) të formës BOT (Build, Operate, Transfer ose Ndërtim, Operim, Transferim) më 21 shtator 2012 për hidrocentralet e listuara më poshtë (kontrata konçesionare). Sipas kësaj Kontrate Konçesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e konçesionarit (grupi i shoqërive që kanë firmosur Kontratën Konçesionare me Qeverinë) i transferohen automatikisht Shoqërisë Konçesionare e cila është krijuar me qëllimin e vetëm të ndërtojë, operojë dhe transferojë hidrocentralet. Konçesionari themeloi Mati Hydropower sh.p.k më 11 tetor 2012. Që prej themelimit, Mati Hydropower sh.p.k (Shoqëria Konçesionare) gëzon gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kontrata e Konçesionit. Në dhjetor 2012, 90% e aksioneve të shoqërisë u blenë nga Enso Hydro Energji sh.p.k.

Objektivi i vetëm i aktivitetit të Shoqërisë Konçesionare është projektimi, ndërtimi dhe funksionimi, menaxhimi dhe transferimi i hidrocentralit pas mbarimit të periudhës së konçesionit tek Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues garanton blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për 15 vitet e para të prodhimit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria mund ta shesë energjinë elektrike të prodhuar në tregun e lire.

Bazuar në kontratën e konçesionit, Shoqëria Konçesionare do të ndërtojë dhe përdorë hidrocentralet përkatëse mbi lumin Mat dhe ka gjithashtu të drejtë të ndryshojë karakteristikat teknike të përcaktuara në Kontratën e Konçesionit me qëllim optimizimin operativ të hidrocentraleve.

Investimi total i miratuar është në shumën e 4,069,596 mijë Lekë. Hidrocentralet e Shoqërisë priten të kenë një fuqi totale të instaluar prej 31,700 kW për prodhimin e 133,259,000 kW/h.

Tarifa e konçesionit që duhet paguar nga Shoqëria është në masën e 5% të energjisë së prodhuar. Gjithashtu, Shoqëria është e detyruar të investojë 60% të vlerës totale të investimit në makineri dhe pajisje në mënyrë që t'i transferojë aktivin kontraktorit në kushte të plota operative.

Periudha e Konçesionit është 35 vjet.

### **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

#### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratuara nga Ministria e Financave.

# **Mati Hydropower sh.p.k.**

## **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

### **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

#### **2.1 Deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)**

Sipas SKK 11 "Mbi Tatimin Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2016.

Në mungesë udhëzimi nga SKK në lidhje me kontratat e shërbimeve konçensionare, Kontrata e Konçensionit është llogaritur dhe paraqitur në përputhje me KIRFN 12 "Shërbimet e Kontratave të Konçensionit".

#### **2.2 Parimi i vijimësisë**

Drejtimi ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë. Në marrjen e këtij vendimi, Drejtimi mori në konsideratë planet e biznesit të Shoqërisë, përfshirë këtu parashikimet e fitimit dhe mjeteve monetare si edhe ecurinë e ndërtimit të aktiveve konçensionare dhe të drejtën e burimeve financiare nga Grupi.

Mati Hydropower sh.p.k. nuk ka gjeneruar të ardhura gjatë 2016 dhe në 2015. Projekti është akoma në fazën e investimit dhe tipi i projektit dhe investimit kërkojnë kohë të konsiderueshme. Prodhimi pritet të fillojë në vitin 2017.

#### **2.3 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

#### **2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha e ambientit ekonomik kryesor në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

#### **2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykim në procesin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga këto rishikime. Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurisë dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të konsiderueshëm ndaj shumave të njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Gjykimet në lidhje me trajtimin e kontratës konçensionare dhe aktiveve të lidhura me të paraqitën në këto pasqyra financiare në shënimet 3.2 dhe 3.4.

### **3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi i zërave monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurset e ndryshme përkatëse të këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

# **Mati Hydropower sh.p.k.**

## **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.2 Instrumente financiarë**

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalente*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme për llogaritë kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve fillestare të tyre. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogaritë e arkëtueshme konçesionare*

Shuma për t'u arkëtuar nga KESH (e drejta e shoqërisë për të kërkuar pagesë nga ana e KESH në lidhje me shitjen e energjisë në 15 vitet e para të veprimtarisë së objektit të konçesionit) njihet në pasqyrat financiare si aktiv financiar (llogari të arkëtueshme nga konçesioni) dhe klasifikohen si të tilla.

Në përputhje me marrëveshjen e konçesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria ka të drejtën të faturojë KESH për shitjen e energjisë elektrike (shitja e të cilës është garantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) për 15 vitet e para të veprimtarisë së hidrocentralit të Matit.

Vlera e aktivitetit financiar është llogaritur në përpjesëtim të drejtë për periudhën e konçesionit, 15 vjet nga 35 vjet, për të gjitha kostot e ndërtimit deri në datën e raportimit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme njihen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Huamarrjet*

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar.

#### *Të tjera*

Instrumente të tjerë financiar jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 3. Politikat kontabël (vazhdim)

#### 3.3 Aktive afatgjata materiale

##### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten nën aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

##### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve jomateriale dhe përmirësimit të ambienteve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera afatgjata mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale është si më poshtë:

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilie dhe orendi	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

#### 3.4 Aktivet afatgjata jo-materiale (të drejta nga marrëveshja e konçesionit)

Të ardhurat që do të merren nga marrëveshja e konçesionit për ndërtimin e objektit të marrëveshjes njihen me vlerën e drejtë, në përputhje me KIRFN 12.

Shoqëria ka zbatuar modelin e kombinuar të KIRFN 12 në mungesë të udhëzimeve specifike nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Në përputhje me marrëveshjen e konçesionit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shoqëria ka të drejtën të faturojë për shitjen e energjisë elektrike ndaj KESH sh.a (shitja e të cilës është garantuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) për 15 vitet e para të veprimtarisë së hidrocentralit të Matit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria është e lirë të shesë energjinë elektrike të prodhuar në treg.

Shuma për t'u arkëtuar nga KESH sh.a. (e drejta e shoqërisë për të kërkuar pagesë nga ana e KESH në lidhje me shitjen e energjisë në 15 vitet e para të veprimtarisë së objektit të konçesionit) njihet në pasqyrat financiare si aktiv financiar (llogari të arkëtueshme nga konçesioni) dhe klasifikohen si të tilla.

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 3. Politikat kontabël (vazhdim)

#### 3.4 Aktivët afatgjatë jo-materiale (të drejta nga marrëveshja e konçesionit)

Diferenca e kostove të ndërtimit njihet si aktiv afatgjatë jo-material dhe do të amortizohet përgjatë jetës së mbetur të marrëveshjes së konçesionit pas mbarimit të periudhës së shitjeve të garantuara prej 15 vjetësh.

Shoqëria njihet si aktivët jo-materiale deri në masën që shoqëria ruan të drejtën për të faturuar klientët e saj përgjatë periudhës 20 vjeçarit të fundit të periudhës së konçesionit.

Vlera fillestare përfaqëson diferencën midis kostos së ndeshur për ndërtimin e objektit të konçesionit dhe aktivitetit të njohur financiar.

Modeli i përdorur nga shoqëria është modifikuar duke shpërndarë në përpjesëtim të drejtë shumat midis aktiveve financiare dhe atyre afatgjatë jo-materiale.

Duke qenë se shoqëria do të paguhet pjesërisht nga një aktiv financiar (shuma e garantuar) dhe pjesërisht nga aktive afatgjatë jo-materiale (diferenca apo e drejta për të përdorur objektin më pas), secili përbërës kontabilizohet veçmas.

Aktivët afatgjatë jo-material është njohur për diferencë midis totalit të kostove dhe aktivitetit financiar.

#### 3.5 Zhvlerësimi

##### (i) Aktivët financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuara, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### (ii) Aktivët jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.6 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

# **Mati Hydropower sh.p.k.**

## **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)*

---

### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.7 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

#### **3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

#### **3.10 Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre**

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Shqipërisë ka nxjerrë disa ndryshime të standardeve ekzistuese të cilat janë miratuar nga Ministria e Financave më 22 Korrik 2014. Standardet e ndryshuara janë të detyrueshme për vitin që fillon më 1 janar 2015 ose më vonë.

Të gjitha standardet hyjnë në fuqi për periudhat pas 1 janar 2015.

SKK 1 "Kudri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare" (i ndryshuar)

SKK 2 "Paraqitja e pasqyrave financiare" (i ndryshuar)

SKK 3 "Instrumentet financiare" (i ndryshuar)

SKK 4 "Inventarët" (i ndryshuar)

SKK 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" (i ndryshuar)

SKK 6 "Provizionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara" (i ndryshuar)

SKK 7 "Kontabilizimi i qirave" (i ndryshuar)

SKK 8 "Të ardhurat" (i ndryshuar)

SKK 9 "Kombinimet e bizneseve" (i ndryshuar) dhe SKK 14 "Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve" (i ndryshuar)

SKK 10 "Grantet dhe format e tjera të ndihmës" (i ndryshuar)

SKK 11 "Tatimi mbi fitimin" (i ndryshuar)

SKK 12 "Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve" (i ndryshuar)

SKK 13 "Aktivet biologjike" (i ndryshuar)

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 4. Mjetet monetare dhe ekuivalente

	31.12.2016	31.12.2015
Arka	422,324	5,568
Banka në Lekë	9,004	173,628
Banka në Euro	9,971	125,556
<b>Totali</b>	<b>441,299</b>	<b>304,752</b>

### 5. Aktive të tjera afatshkurtra

	31.12.2016	31.12.2015
TVSH e arkëtueshme	140,493,803	129,147,799
Pjesa aktuale e policës së sigurimit	2,603,480	-
Parapagime	2,325,736	-
<b>Totali</b>	<b>145,423,019</b>	<b>129,147,799</b>

TVSH e arkëtueshme lind nga ndërtimi i aktiveve konçesionare pasi shërbimet e ofruar nga furnitorët e shoqërisë janë subjekt i TVSH. TVSH e rimbursueshme do të kompensohet kundrejt detyrimeve të ardhshme nga shitja e energjisë.

### 6. Aktive afatgjata materiale

	Pajisje informatike	Mjete transporti	Mobilje dhe orendi	Totali
<b>Kosto</b>				
Më 1 janar 2015	-	2,849,931	188,333	3,038,264
Shtesa	87,624	-	77,500	165,124
Më 31 dhjetor 2015	87,624	2,849,931	265,833	3,203,388
Shtesa				
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>87,624</b>	<b>2,849,931</b>	<b>265,833</b>	<b>3,203,388</b>
<b>Amortizimi</b>				
Më 1 janar 2015	(1,826)	(691,170)	(74,474)	(767,470)
Shpenzime	(21,450)	(431,751)	(38,272)	(491,473)
Më 31 dhjetor 2015	(23,276)	(1,122,921)	(112,746)	(1,258,943)
Shpenzime	(16,088)	(345,400)	(30,616)	(392,104)
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(39,364)</b>	<b>(1,468,321)</b>	<b>(143,362)</b>	<b>(1,651,047)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
Më 31 dhjetor 2015	64,348	1,727,010	153,087	1,944,445
Më 31 dhjetor 2016	48,260	1,381,610	122,471	1,552,341

### 7. Llogari të arkëtueshme nga koncesioni

Duke filluar nga 31 dhjetor 2016, përqindja e njohur si një aktiv financiar e kostove të ndërtimit të realizuara deri në momentin e raportimit është 43%, ose 299,869 mijë lekë (2015: 266,017 mijë lekë). Diferenca prej 57% njihet si aktiv afatgjatë jo-material (shënimi 8). Ndarja që Shoqëria i bën kostove të ndërtimit të aktivit konçesionar shpjegohet në shënimet 3.2 dhe 3.4. Aktivi financiar matet me kosto të amortizuar.

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 8. Aktive afatgjata jo materiale

	Të drejta nga konçesioni
<b>Kosto</b>	
Më 1 janar 2015	
Shtesa	307,118,813
Më 31 dhjetor 2015	47,570,587
Shtesa	354,689,400
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>45,135,381</b>
	<b>399,824,781</b>
<b>Amortizimi</b>	
Më 1 janar 2015	-
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2015	-
Shtesa	-
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>-</b>
	<b>-</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>	
Më 31 dhjetor 2015	354,689,400
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>399,824,781</b>

### 9. Llogari të pagueshme

	31.12.2016	31.12.2015
Furnitorë	21,992,995	4,551,157
Detyrime ndaj palëve të lidhura (Shënimi 17)	79,129,351	53,054,512
<b>Totali</b>	<b>101,122,346</b>	<b>57,605,669</b>

Detyrimet ndaj palëve të lidhura konsistojnë kryesisht në shërbimet e konsulencave ligjore dhe teknike.

### 10. Detyrime të tjera

	31.12.2016	31.12.2015
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	149,268	137,934
Detyrime tatimore për TAP-in	283,600	261,516
Detyrime të tjera	39,354	6,355,265
Detyrime për pagat dhe të tjera	632,516	602,370
<b>Totali</b>	<b>1,104,738</b>	<b>7,357,085</b>

### 11. Huatë

	31.12.2016	31.12.2015
Huatë nga aksionerët	691,363,375	630,732,960
Interesi i përlogaritur	65,300,221	39,752,827
<b>Totali</b>	<b>756,663,596</b>	<b>670,485,787</b>

Huatë nga aksioneri, Enso Hydro Energji sh.p.k.përdoren për investime në lidhje me aktivet konçesionare.

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 11. Huatë (vazhdim)

Huadhënësi	Vlera e huasë në '000 Lekë	Monedha	Vlera e huasë ne Eur	Data e huasë	Interesi i përlllogaritur në '000 Lekë
Enso Hydro Energji sh.p.k.	67,615	EUR	500,000	13.01.14	11,649
Enso Hydro Energji sh.p.k.	13,523	EUR	100,000	14.04.14	2,094
Enso Hydro Energji sh.p.k.	47,331	EUR	350,000	13.05.14	7,065
Enso Hydro Energji sh.p.k.	27,046	EUR	200,000	02.09.14	3,457
Enso Hydro Energji sh.p.k.	12,171	EUR	90,000	19.12.14	1,303
Enso Hydro Energji sh.p.k.	3,381	EUR	25,000	09.02.15	324
Enso Hydro Energji sh.p.k.	432,736	EUR	3,200,000	26.02.15	37,115
Enso Hydro Energji sh.p.k.	13,523	EUR	100,000	10.06.15	912
Enso Hydro Energji sh.p.k.	3,381	EUR	25,000	04.11.15	135
Enso Hydro Energji sh.p.k.	609	EUR	4,500	15.12.15	19
Enso Hydro Energji sh.p.k.	1,352	EUR	10,000	14.01.16	39
Enso Hydro Energji sh.p.k.	14,875	EUR	110,000	12.02.16	399
Enso Hydro Energji sh.p.k.	24,341	EUR	180,000	14.04.16	526
Enso Hydro Energji sh.p.k.	6,762	EUR	50,000	03.08.16	84
Enso Hydro Energji sh.p.k.	2,434	EUR	18,000	19.09.16	21
Enso Hydro Energji sh.p.k.	20,283	EUR	150,000	28.09.16	158
<b>Total</b>	<b>691,363</b>		<b>5,112,500</b>		<b>65,300</b>

Huatë janë ofruar për një periudhë të pacaktuar. Huatë janë të pagueshme 6 muajt e parë pas fillimit të prodhimit të energjisë nga hidrocentrali, i cili pritët të fillojë punë në 2017.

### 12. Kapitali i paguar

Kapitali i nënshkruar përbëhet nga 931,000 kuota me vlerë nominale ALL 100 Lekë për kuotë. Lëvizjet në pasqyrën e kapitalit janë si më poshtë:

	Nr. i kuotave	Vleranominale
Më 1 janar 2015	<b>1,000</b>	<b>100,000</b>
Kapitali i paguar	930,000	93,000,000
Më 31 dhjetor 2015	931,000	93,100,000
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>931,000</b>	<b>93,100,000</b>

### 13. Shpenzime për personelin

	31.12.2016	31.12.2015
Pagat e personelit	10,556,524	10,166,459
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	894,761	851,387
<b>Totali</b>	<b>11,451,285</b>	<b>11,017,846</b>

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 14. Shpenzime operative

	31.12.2016	31.12.2015
Konsulencë ligjore	5,218,690	2,257,310
Shpenzime për auditim dhe konsulencë takse	2,060,535	1,710,253
Qira	1,077,050	1,095,043
Shpenzime udhëtimi	698,108	382,589
Shpenzime për makina dhe qira	659,991	322,352
Të tjera	738,585	308,293
Shpenzime të tjera konsulence	323,233	4,827,081
Shpenzime transporti	229,212	604,551
Shpenzime zyre	209,047	293,499
Shpenzime përkthimi	160,600	138,000
Shpenzime bankare	80,200	98,371
Shpenzime siguracioni	15,298	89,372
Shpenzime të tjera komunikimi	83,716	50,687
Taksa të ndryshme nga tatim fitimi	67,000	18,120
<b>Totali</b>	<b>11,621,265</b>	<b>12,195,521</b>

### 15. Të ardhura nga kursi i këmbimit

	31.12.2016	31.12.2015
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	21,013,298	15,632,616
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(8,354,457)	(1,245,117)
<b>Totali</b>	<b>12,658,841</b>	<b>14,387,499</b>

### 16. Tatimi mbi fitimin

Norma e tatimit mbi fitimin e Shoqërisë është 15% për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (2015:15%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë-deklarime provizore deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin përfundimtar. Legjislacioni fiskal shqiptar është subjekt interpretimesh nga autoritetet fiskale.

	31.12.2016	31.12.2015
Humbja e vitit	(30,714,532)	(40,951,302)
Shpenzimet e pa-zbritshme	21,883,965	33,148,991
<b>Humbja e mbartur e vitit</b>	<b>(8,830,567)</b>	<b>(7,802,311)</b>

Humbjet e Shoqërisë të mbartura nga viti 2013 skadojnë në 2017 dhe nuk mund të përdoren për të netuar shpenzimet e ardhshme të tatim fitimit bazuar në planin e biznesit të Shoqërisë. Humbjet nga taksat të mbartura nga viti 2014 dhe 2015 pritet të netojnë të ardhurat që Shoqëria pret të gjenerojë në 2018 (duke përdorur normat në fuqi të tatim fitimit).

### 17. Palë të lidhura

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së biznesit, Shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura. Balancat dhe transaksionet e Shoqërisë me palët e lidhura në datën e bilancit janë si më poshtë:

# Mati Hydropower sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

## 17. Palë të lidhura (vazhdim)

	Marrëdhënia	31.12.2016	31.12.2015
<b>Aktive</b>			
<b><u>Shtesa Aktivët afatgjatë</u></b>			
<b><u>jomateriale dhe llogaritë e</u></b>			
<b><u>arkëtueshme nga konçesioni</u></b>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	28,486,197	83,548,527
Enso GmbH		24,818,290	-
<b>Detyrime</b>			
<b><u>Të pagueshme për aktivitetin e</u></b>			
<b><u>shfrytëzimit</u></b>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	74,070,504	52,163,912
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	5,058,847	890,597
Enso GmbH		15,494,530	-
<b><u>Huamarrie</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	756,663,596	670,485,787
<b>Pasqyra e performancës</b>			
<b><u>Shpenzime operative</u></b>			
Enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	0	4,177,810
<b><u>Shpenzime interesi dhe shpenzime</u></b>			
<b><u>të ngjashme</u></b>			
Enso Hydro Energji sh.p.k.	Shoqëria mëmë	19,908,720	31,633,961
		28,486,197	83,548,527

## 18. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara

### **Angazhime për investime kapitale**

Bazuar në kontratën e konçesionit, shoqëria është e detyruar të investojë të paktën 60% të vlerës totale të investimit në makineri dhe pajisje në mënyrë që aktivi t'i transferohet kontraktorit në kushte të plota operative. Si rezultat, shoqëria ka një angazhim prej të paktën 2,441,758 mijë Lekë për makineri dhe pajisje për t'u blerë në fund të periudhës së konçesionit prej 35 vitesh (60% e investimit total siç shpjegohet në shënimin 1). Riinvestimet priten të konsistojnë kryesisht në riparimin dhe mirëmbajtjen e investimit fillestar.

### **Detyrime të kushtëzuara ligjore**

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së biznesit, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore. Sipas opinionit të Drejtimit, vendimi përfundimtar i këtyre çështjeve nuk do ketë efekt material negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë, ose ndryshime në aktivet fikse.

### **Detyrime të kushtëzuara fiskale**

Legjislacioni tatimor shqiptar në fuqi në fund të periudhës raportuese është subjekt interpretimesh të ndryshme kur zbatohet ndaj veprimeve dhe aktiviteteve të shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i përcaktuar nga drejtimi dhe dokumentacioni formal i cili mbështet këtë pozicion mund të kundërshtohet nga autoritetet tatimore. Periudhat fiskale konsiderohen të hapura për rishikim të çështjeve tatimore nga autoritetet fiskale për tre vite kalendarike duke filluar nga viti para se të merret një vendim në lidhje me rishikimin. Në raste të caktuara, rishikimet mund të mbulojnë një periudhë më të gjatë.

Detyrimet e regjistruara në lidhje me pozicionin fiskal të shoqërisë janë përcaktuar nga drejtimi duke u bazuar në rezultatet më të mundshme në rast se përlllogaritjet do të kryheshin nga autoritetet fiskale. Vlerësimi bazohet në interpretimet e legjislacionit tatimor që është në fuqi në fund të periudhës së raportimit dhe ndonjë vendim gjyqësor apo interpretim i njohur i autoriteteve. Detyrimet për penalitete, interesa dhe tatime të tjera përveç tatimit mbi të ardhurat njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të drejtimit në lidhje me shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës së raportimit.

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 19. Menaxhimi i riskut financiar

#### a. Risku i kredisë

Tabela vijuese prezanton ekspozimin e kompanisë ndaj riskut të kredisë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare	441,299	304,752
Të arkëtueshme nga konçesioni	299,868,586	266,017,050
<b>Total</b>	<b>300,309,885</b>	<b>266,321,802</b>

#### b. Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku me të cilin Shoqëria do hasë vështirësi në gjetjen e fondeve për të përmbushur angazhimet që lidhen me instrumentet financiare. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj në baza periodike në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj, si dhe kur ato maturohen.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë hartuar duke u bazuar në maturimet kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare:

31 dhjetor 2016	Më pak se 1 muaj	Nga 1 muaj në 1 vit	Nga 1 deri në 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare	441,299	-	-	441,299
Të arkëtueshme nga konçesioni	-	-	299,868,586	299,868,586
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>441,299</b>	<b>-</b>	<b>299,868,586</b>	<b>300,309,885</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogari të pagueshme	-	101,122,346	-	101,122,346
Huamarrje	65,300,221	-	691,363,375	756,663,596
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>65,300,221</b>	<b>101,122,346</b>	<b>691,363,375</b>	<b>857,785,942</b>
<b>Hendeku i likuiditetit</b>	<b>(64,858,922)</b>	<b>(101,122,346)</b>	<b>(391,494,789)</b>	<b>(557,476,057)</b>

31 dhjetor 2015	Më pak se 1 muaj	Nga 1 muaj në 1 vit	Nga 1 deri në 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare	304,752	-	-	304,752
Të arkëtueshme nga konçesioni	-	-	266,017,050	266,017,050
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>304,752</b>	<b>-</b>	<b>266,017,050</b>	<b>266,321,802</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogari të pagueshme	-	57,605,669	-	57,605,669
Huamarrje	39,752,827	-	630,732,960	670,485,787
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>39,752,827</b>	<b>57,605,669</b>	<b>630,732,960</b>	<b>728,091,456</b>
<b>Hendeku i likuiditetit</b>	<b>(39,448,075)</b>	<b>(57,605,669)</b>	<b>(364,715,910)</b>	<b>(461,769,654)</b>

# Mati Hydropower sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë në Lekë përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

### 19. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

#### c. Risku i kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit, është risku se vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. Kompania kryhen transaksione në monedhë të huaj që lidhen me aktivitetin financiar dhe operativ të saj. Kompania nuk përdor ndonjë instrument të veçantë për tu mbrojtur ndaj këtij risku. Pjesa më e madhe e transaksioneve të kompanisë është në Euro dhe në Lekë dhe duke qënë se kursi i këmbimit Euro/Lekë është i qëndrueshëm, risku i kursit të këmbimit konsiderohet i ulët.

31 dhjetor 2016	EUR	ALL	Total
<b>Aktive financiare</b>			
Mjete monetare	61,312	379,987	441,299
Të arkëtueshme nga konçesioni	294,086,650	5,781,936	299,868,586
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>294,147,962</b>	<b>6,161,923</b>	<b>300,309,885</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Llogari të pagueshme	95,820,365	5,301,981	101,122,346
Huamarrje	756,663,596	-	756,663,596
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>852,483,961</b>	<b>5,301,981</b>	<b>857,785,942</b>
<b>Pozicioni financiar neto</b>	<b>(558,335,999)</b>	<b>859,942</b>	<b>(557,476,057)</b>

  

31 dhjetor 2015	EUR	ALL	Total
<b>Aktive financiare</b>			
Mjete monetare	130,315	174,437	304,752
Të arkëtueshme nga konçesioni	-	266,017,050	266,017,050
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>130,315</b>	<b>266,191,487</b>	<b>266,321,802</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Llogari të pagueshme	56,711,198	894,471	57,605,669
Huamarrje	670,485,787	-	670,485,787
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>727,196,985</b>	<b>894,471</b>	<b>728,091,456</b>
<b>Pozicioni financiar neto</b>	<b>(727,066,670)</b>	<b>265,297,016</b>	<b>(461,769,654)</b>

### 20. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare.